

University of Business and Technology in Kosovo

UBT Knowledge Center

Theses and Dissertations

Student Work

Spring 6-2011

Diplomacia Shqiptare pas Luftës së Dytë Botërore deri më sot

Gresë Kelmendi

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>



Part of the [Law Commons](#)



Universiteti për Biznes dhe Teknologji
Departamenti i Shkencave Politike dhe Diplomacisë

Diplomacia Shqiptare pas Luftës së Dytë Botërore deri më sot
Shkalla Bachelor

Gresë Kelmendi

Qërshor / 2011
Prishtinë



Universiteti për Biznes dhe Teknologji
Departamenti i Shkencave Politike dhe Diplomacisë

Punim Diplome
Viti akademik 2007 – 2011

Gresë Kelmendi

Diplomacia Shqiptare pas Luftës së Dytë Botërore deri më sot

Mentori: Emrush Ujkani

Qërshor / 2011

Ky punim është përpiluar dhe dorëzuar në përmbushjen e kërkesave të pjeshme për Shkallën Bachelor

ABSTRAKT

Historia Shqiptare ndër vite është mjaft e pasur me peripeti të larmishme, duke filluar nga Ilirët,si para ardhës së popullit Shqiptar e gjer tek Regjimi Komunist i udhëhequr nga Komunisti përbetuar Enver Hoxha.Shqipëria qysh në vitet e hershme të shpalljës së pavarësisë në Vlorë 1912,mund të thuhet se përgatiste rrugë për një jëtë më të mirë për popullin, mundohej ti fuqizonte dhe ti'i ngriste intelektualisht pas ardhësit politik nga të cilët do të zhvilloheshin edhe diplomacitë ndërkombëtare.Aso kohe pretendohet që Shqipëria do të ishte një vend i cili do të zhvillohej në baza të shkollimit,ekonomisë,kulturës dhe ushtrisë.

Kush do të kishte thënë që Shqipëria në vitet pasuese,veqanërisht në periudhën e pas luftës së dytë botërore do të përballej me situata nga më të ndryshmet,deri tek vetizolimi i shtetit i cili do përfundonte në një periushë pa mbështetjen e asnjë nga super fuqitë e atëherëshme.

Shqipëria jo vetëm që mbeti vetëm falë diplomacisë së bërë të Diktatorit Hoxha i cili adhuronte politikë-bërjen e Stalinit,por edhe populli vuajti mjaftë nga rrethanat në të cilat u ndodh shteti.Diktatori Hoxha,idealizonte regjimin Stalinist dhe nuk ishte pro reformave të këtij regjimi.Nga kjo rrodhi që Enver Hoxha e dërgoi vendin në një gjendje krize të vetë izolimit,dhe kjo periudhë zgjati deri sa regjimi Komunist u rëzua nga zgjedhjet të cilat u mbajtën në Shqipëri në vitet e 90-ta ku Partia Demokratike triumfoi me fitorën të cilën i a kishte dhuruar populli i cili kishte vuajtur për frymë demokratike.

FJALOR I TERMAVE-AKRONIMEVE

KNER -Këshillit Ekonomik e Ndhmës Reciproke

PKBS –Partia Komuniste e Bashkimit Sovietik

SHBA-Shtetet e Bashkuara të Amerikës

OKB –Organizata e Kombeve të Bashkuara

NATO –Organizata e Traktaktit Atlantik të Veriut

BS –Bahkimi Sovietik

PD –Partia Demokratike

PS-Partia Socialiste

PËRMBAJTJE

Abstrakt.....	I
Fjalor I Termave/Akronimeve	II
Hyrje	3
Hyrje në Historinë Shqiptare.....	3
Kreu I	
Diplomacia shqiptare pas Luftës së Dytë Botërore.....	4
1.1. Shqipëria dhe Ballkani	4
1.2. Ballkani si pjesë e Europës lindore dhe efektet e Jaltës dhe Potsdamit.....	5
Kreu II	
Politika e jashtme e Shqipërisë	7
2.1. Marrëdhëniet mes shqiptarëve dhe jugosllavëve (1944-1948)	7
2.2. Marrëdhëniet shqiptaro-sovjetike	9
Kreu III	
Shqipëria dhe Marrëdhënjet Ndërkombëtare.....	13
3.1. Marrëdhëniet e Shqipërisë me Fqinjët (1944-1961)	13
3.2. Marrëdhëniet e Shqipërisë me Evropën Lindore.....	16
3.3. Marrëdhëniet e Shqipërisë me Perëndimin	17
Kreu IV	
Shqipëria dhe Marrëdhënjet Diplomatike.....	19
4.1. Shqipëria, diplomacia shumëpalëshe dhe Organizatat Ndërkombëtare	19
4.2. Problemet shqiptaro-sovjetike deri te prishja e marrëdhënieve diplomatike.	21

Kreu V

Diplomacia shqiptare dhe Lufta e Ftohtë	24
5.1. Faza e fundit e Luftës së Ftohtë	24
5.2. Doktrina e Regan-it.....	24
5.3. Doktrina Gorbacov	26
5.4. Evropa Perëndimore	28
5.5. Evropa Lindore	29
5.6. Shqipëria dhe politika e saj, pas prishjes së marrëdhënieve ekonomiko- ushtarake me Kinën.....	31

Kreu VI

Diplomacia Shqiptare dhe Sistemi Demokratik	34
6.1 Zgjedhjet elektorale, PD –PS	34
6.2. Fryma e re Diplomatike.....	35
Konkludim	36
Referencat	39

HYRJE

Hyrje në Historinë Shqiptare

Duke u bazuar në Historinë e Shtetit Shqiptar që nga viti 1912 Shqipëria njihet si shtet pas shumë vitesh e okupuar nga Perandoria Osmane. Shqiptarët aso kohe u munduan me çdo kusht ti mbronin të drejtat e tyre dhe t'i mbronin tokat e tyre nga pushtuesit. Për këtë qëllim Shqipëtarët u mbledhën në Prizren dhe krijuan Lidhjen e Prizrenit e cila kishte për qëllim bashkimin e të gjitha trojeve shqiptare apo vilajeteve që aso kohe ishin të ndara në katër: Vilajeti i Shkodrës, Vilajeti i Kosovës, Vilajeti i Manastirit dhe Vilajeti i Janinës. Qëllimi i Shqipëtarëve ishte ta ndërtonin shtetin e tyre në baza të arsimit, gjuhës, kulturës dhe traditave.

Kjo lidhje u shtyp nga Perandoria Osmane me ndihmën e madhe të fuqive Europiane. Ata nuk përkrahën idenë e popullit Shqiptar që tokat e tyre duhej të ishin të bashkuara, andaj këta të fundit edhe e filluan luftën për bashkimin e vilajeteve të tyre.

Gjatë kohës sa Shqiptarët luftonin për bashkimin e trevave të tyre, fqinjët Ballkanas vetëm sa kishin filluar t'i thurnin planet se si ta copëtonin përsri shtetin Shqipëri i cili më 28 Nëntor të vitit 1912, shpalli pavarësinë e tij në krye me Ismail Bej Qemalin në Vlorë.

Menjëherë pas shpalljes së pavarësisë Shqiptare, në Londër u thirrën të gjitha fuqitë botrore të asaj kohe të cilat ishin Britania, Gjermania, Rusia, Austro-Hungaria, Franca dhe Italia. Qëllimi i këtij Kongresi ishte copëtimi i tokave të shtetit të sapo formuar Shqiptar. Këto fuqi kishin vendosur që shtetit të ri Shqiptar t'i vihen kufinj të rinj. Pjesën apo vilajetin e Kosovës dhe pjesën apo vilajetin e Manastirit i dhanë Sërbve ndërsa pjesën apo vilajetin e Janinës ia japën Greqisë. Aso kohe mendohej që një shtet kështu i copëtuar nuk do të kishte mundësi që të vazhdojë tutje, ai do të thyhet shpejtë. Mirëpo Shqipëria vazhdoi të qëndroj e fortë edhe më tutje.

Kreu I

Diplomacia shqiptare pas Luftës së Dytë Botërore 1944- 1961

1.1.Shqipëria dhe Ballkani

Vendimet e dy Konferencave të Jalta-s dhe Potsdam-t

Duke pasur parasyshë që çdo luftë përfundon me bisedime,bisedime të cilat kërkojnë të gjejnë mënyrën më të mirë të funksionimit të një apo më shumë shteteve të dalura nga lufta. Të lartëpërmendurit kërkojnë të gjejnë paqë, stabilitet,sundim të ligjit apo drejtësi dhe fuqizim ekonomik.Andaj nëse luftërat i provokojnë politikat të cilat vetëm japin mundin dhe fuqitë e tyre që t'i realizojnë ushtarakët apo ushtrinë e cila është arma më e fortë e secilit shtet , ato i përfundojnë diplomatët. Kështu ndodhi edhe pas Luftës së Dytë Botërore. Atë luftë e përfunduan dy Konferencat Ndërkombëtare, e Jaltes dhe e Potsdamit. Këto dy konferenca ndanë pasluftën, përcaktuan ata të cilët shquheshin sikur humbësit dhe ata të cilët u quajtën fituesit. Ndanë shëndritjen e shteteve të reja dhe ndarjet gjeo-politike në mes të dy Blloqeve kryesore të asaj kohe.Ndryshimi midis tyre qëndronte rreth faktin se nëse Jalta ishte fundi i bashkëpunimit ndër aleat Perëndim-Bashkimi Sovjetik, Potsdami ishte fillimi i Luftës së Ftohtë.

Disa fakte :

Jalta, (4-11 shkurt 1945) por që iu përmbajt edhe Potsdami u përqendrua në pesë çështje:

Së pari, pranoi strukturën e një organizate ndërkombëtare, sigurinë kolektive, sistemin e të drejtës ndërkombëtare moderne.

Së dyti, Fuqitë ranë dakort të rimëkëmbin Evropën e dëmtuar nga lufta. Efekti praktik i kësaj mase do ishte i ndryshëm në dy anët e Luftës së Ftohtë.

Së treti, u ra dakort për t'u ndarë Gjermania në katër zona të mëdha nën kontrollin e Fuqive fituese të luftës.

Së katërti, u ra dakort për të mbështetur qeveritë e krijuara nga BS, të bëheshin zgjedhje të lira demokratike pas pak kohësh dhe të fiksoheshin hapsirat e Bashkimit Sovjetik gjeopolitkisht në Perëndim të Polonisë duke i zgjeruar ato.

Së pesti, u përcaktuan detyrimet reparative që Gjermani do të duhej t'i jepte BS për dëmet e shkaktuara gjatë luftës.

Vendimet e Jaltës dhe ato që pasuan pak më vonë ,Potsdamin i hodhi mbi Evropën epokën e Perdes së Hekurt. Ato vërtetuan praktikisht atë që Stalini kishte pasë deklaruar në bisedime me një prej udhëheqësve kryesorë jugosllav, malazezin Milovan Gjilas gjatë luftës, së “ku do shtrihet Ushtria e Kuqe do vendoset sistemi Sovjetik”. Madje, siç ishte rasti i Shqipërisë, sistemi sovjetik do shtrihej edhe përtej vijës së Ushtrisë së Kuqe.

1.2.Ballkani si pjesë e Europës lindore dhe efektet e Jaltës dhe Potsdamit

Gjatë kohës që u morrën vendimet e Konferencës së Jaltës dhe Potsdamit,Ballkani pësoi pasoja mjaft të mëdha.Sa i përket Bllokut Lindorë dhe ai Perëndimorë ,u ndanë edhe me tutje në rajone duke vendosur nje ekuilibër unik për Luftën e Ftohtë.

Rajonet u ndanë në këtë mënyrë:

- Greqi dhe Turqi në Bllokun Perëndimorë
- Bullgaria dhe Rumania në Bllokun Lindorë
- Shqipëria dhe Jugosllavia jashtë dy Blloqueve (me ndryshime respektive)

Kjo ndarje do të kishte shumë pasoja edhe në zhvillimet e mëtejshme politike, ekonomike e strategjike të Ballkanit. Pas Luftës së Ftohtë kjo ndarje vonoi çdo lloj procesi në këtë rajon.

Kreu II

Politika e jashtme e Shqipërisë, 1944-1961

2.1.Marrëdhëniet mes shqiptarëve dhe jugosllavëve (1944-1948)

Politika e jashtme e Shqipërisë pas Luftës së Dytë Botërore deri në vitin 1961 kalon nga vasale e Jugosllavise (1944-1948) në satellite të plota politike të Bashkimit Sovjetik (1948-1961).

Periudha nga 1944-1948 e beri prioritet në politikën e jashtme, Jugosllavinë e Titos, në planin i cili ishte bërë për organizim politik, ekonomik dhe ushtarak të rajonit. Duke i përjashtuar të gjitha veprimet formale diplomatike me shtetet të tjera, gjegjësisht gjatë kësaj periudhe çdo gjë që lidhej me Shqipërinë dhe popullin shqiptarë ku do në Ballkan, i identifikonin si Jugosllavë apo atë e identifikonin edhe me kanalet Jugosllave. Siç edhe ka dëshmuar bota që shume vonë ka filluar të kuptoj fakte rreth popullit Shqiptar, apo të themi qartë rreth vilajeteve të ndara që ato tani më i u kishin dhuruar Serbëve dhe Grekëve.

Shqiptarët aso kohe nuk i ndihmonte as edhe marrëdhëniet e mira me Bashkimin Sovietik dhe Stalinin nuk zhvilloheshin në mënyrë të drejtpërdrejt, por nëpërmjet Beogradit. Moska atë kohë kishte mjaft pak dituri dhe mjaft pak interes për zhvillimet politike në Shqipëri. Në Jalte dhe Potsdam, madje edhe në Konferencën e Paqes në Paris 1946, Shqipëria si aleate e Frontit Antifashist nuk u konsiderua e rëndësishme as nga Lindja as nga Perëndimi. Ishte një harresë shumë e padrejtë që i bëhej një populli që luftoi e sakrifikoi shumë në anën e Aleatëve antifashistë.

Shqipëria dhe prioritete e politikës së saj ndaj Jugosllavisë dhe qëllimet ishin:

- Prapavija politiko- historike për arsye të vendit dhe rolit të komunistëve Jugosllavë dhe të vetë Titos për krijimin lëvizjen komuniste e më pas antifashiste në Shqipëri nga 1941-1945;

- dobësitë e shtetit shqiptarë,

- epërsitë e Jugosllavisë si shtet i madh,
- Amaterët e politikës dhe diplomacisë shqiptare pas Luftës përballë profesionalizmit dhe përvojës së Titos, Gjilasis, Pijades, Kardelit dhe Rankovicit.
- strategjia apo plani i jugosllavëve për të mbajtur të zotëruara Kosovën dhe viset shqiptare nga rreziku i shkëputjes që mund të provokonte Lufta e Dytë Botërore.

Pasojat e politikës ndaj Jugosllavisë ishin të mëdha dhe kërcënuese;

Si pikë e parë që të flitet rreth pasojave është falimentimi thuajse i tërë i ekonomisë shqiptare e cila ishte mjaft e dobët dhe e lodhur nga Lufta;

Së dyti, vunë nën kontroll politik thuajse gjithë strukturat partiake dhe shtetërore përmes rolit të agjentëve të tyre të infiltruar në Shqipëri deri në nivelet më të larta;

Së treti, paralizuan çdo iniciativë të pavarur diplomatike Shqiptare;

Së katërti, sabotuan krejtësisht përpjekjet e Shqipërisë për krijimin e trupave të armatosura;

Së fundi, rrezikuan përfundimisht çështjen shqiptare nën Jugosllavi.

Gjatë kohës kur situata e sovranitetit shtetëror rrezikohëj edhe më tepër, Tito si një agjent mjaft i vjetër i Perëndimit filloi gradualisht të shkëputej nga Stalini dhe Bashkimi Sovietik. Atë kohë filloi konkurrenca mes Moskës dhe Beogradit se kush do të kishte fuqi dominuese mbi Ballkanin..

Gjatë viteve 1947-48 konflikti në mes të Titos dhe Stalinit çoi në përjashtimin e Lidhjes Komuniste nga Kominterni. Kjo situatë mundësoi udhëheqjes Shqiptare ta përdorin këtë moment dhe ta njoftonin Stalinin mbi kërcenimet politike që i kanoseshin Shqipërisë dhe Jugosllavisë. Stalini si një strateg i mirë i at'hershëm, përkrahi Shqipërinë dhe e cilësoi si vend favorit të Ballkanit. E gjithë kjo ishte vetëm strategji e tij pasi që kishte kuptuar që duke e pasur parasyshë që Tito ishte kroat anti rus, tani më kishte ndruar orientimin politik dhe përkrahte Perëndimorët.

Falë kësaj gjendje apo lidhje të komunistit Enver Hoxha dhe lidhjes së tij miqësore me Stalinin, Shqipëria arriti të shpëtoi nga kërcënimet e kohë pas kohëshme që i vinin nga Jugosllavia e Titos. Pasi që Stalini ndërhyri në reagimin e diferencuar të Tiranës, në eliminimin e agjentëve jugosllavë të cilët ishin nën udhëheqjen shqiptare, politika e jashtme e Shqipërisë u shkëput nga Jugosllavët dhe marrëdhëniet mes Moskës dhe Evropës Lindore përgjithësisht i bëri prioritet. Gjatë viteve të 1948-1953 marrëdhëniet dypalëshe shqiptaro-sovjetike ishin më të ndriturat .

2.2 Marrëdhëniet shqiptaro-sovjetike dhe fazat e tyre.

Faza e parë, përfshinë periudhën 1948-1953. Ishte periudha kur Bashkimi Sovietik e udhëhoqte Stalinin. Në këtë periudhë u krijuan bazat e bashkëpunimit dypalësh politik, ideologjik ushtarak, ekonomik e kulturorë. Në atë periudhë Stalini tregoi vëmendje në rritjen e Shqipërisë. Në këtë kohë u realizuan takime në nivelet më të larta Enver-Stalin dhe të të gjitha fushave të bashkëpunimit. Stalini e konsideroi shumë të rëndësishme t'i u ipte ndihma ekonomike Shqipërisë, mbështeti ata në shumicën e bazave të ekonomisë, fuqizoi ushtrinë shqiptare, ai gjithashtu u dha bursa të shumta për arsimimin e kuadrove të të gjitha sektoreve dhe solli këshilltarë të lartë në pothuajse gjithë pikat kyçe të drejtimit të Shtetit. Në planin ndërkombëtarë Bashkimi Sovietik mbështeti Shqipërinë për tu integruar në strukturat Euro-Lindore dhe ai i u dha mbështetje diplomatike. Ndryshe nga vendet e tjera Euro-lindore që kishin rënë viktime të Bashkimit Sovietik dhe të Ushtrisë së Kuqe, Shqipëria u vetëorientua drejt tij pa diktat e kërcënim prej të lartëpërmendurit, dhe as të Ushtrisë së Kuqe. Regjimi Tiranës e ndoqi vetë rrugën drejt Moskës pa kurrëfarë imponimi ndërkombëtarë.

Faza e dytë, e marrëdhënieve shqiptaro-sovjetike përfshinë periudhën 1953-1957. Në këtë periudhë kemi vdekjen e Stalinit dhe ardhjen në pushtet të Nikita Hrushovit. Ky ndryshim solli lëvizje të kursit politik të Bashkimit Sovietik si brenda ashtu edhe jashtë vendit.

Ndryshimi preku politikën, ekonominë, ushtrinë, jetën ideologjike. Madje ndryshimi preku vetë kultin e Stalinit. Në planin ndërkombëtarë, ndryshime u shfaqën në qëndrimin ndaj sateliteve Euro Lindore dhe elitave politike përkrahës të Stalinit dhe Stalinizmit, në qëndrimin ndaj Perëndimit përgjithësisht dhe në strategjinë ofensive ndërkombëtare që u ndërmor në atë kohë.

Si fillim ishte mbështetës i Shqipërisë në të gjitha fushat, ai ndiqte rrugën e Stalinit. Në marrëdhënie me Shqipërinë, Hrushovit nuk kishte strategji të veçantë. Enver Hoxha gjithashtu takohej me Hrushovin, dhe si rezultat u krijuan edhe të tjera vizita që diskutohej për të gjitha fushat, kërkohesh të plotësohej kuadri juridiko formal. Në atë kohë u vendos që Shqipëria të bëhej anëtare e Traktatit të Varshavës qysh në themelimin e tij dhe të bëhej anëtare e Këshillit Ekonomik e Ndihmës Reciproke (KNER-it) në vitin 1955.

Në Kongresin 20-të të PKBS (1956) u shfaq edhe i ashtuquajti Kursi Hrushovian. Përse? Sepse gjatë këtij Kongresi Hrushovi doli me dy raporte: Raportin e veprimtarisë së KQ të PKBS dhe me Raportin Sekret mbi Stalinin. Raporti i parë jepte linjat kryesore të ndryshimeve që synonte të bënte Hrushovi në plan të brendshëm dhe ndërkombëtarë, këtu bënte ndarjen e Euro Lindorëve dhe kundërshtarët Perëndimorë. Raporti i dytë, kishte për qëllim veprimtarinë e fshehtë kriminale të Stalinit dhe abuzimet e pushtetit personal të tij. Nga raporti i dytë dilte mesazhi se Stalini, por edhe stalinistët apo liderët pasues të tij në Europën Lindore duheshin ndryshuar. Në mënyrë që mos të ndodhnin të njëjtat gjëra në botë sikurse në kohën e Stalinit.

Të dy Raportet ishin mjaft të rrëndëshime, ato synonin ndryshime të mëdhaja politike të Bashkimit Sovietik dhe të Europës Lindore ku aplikoheshin e njëjta menyrë e udhëheqjes apo ajo Staliniste. Hrushovi dëshironte të bënte rritje në aspektin brendshëm dhe Ndërkombëtare rreth krijimit të strategjive.

E gjithë kjo politikë e re e Hrushovit i binin ndesh platformës politike së regjimit të Enver Hoxhës, që mbështetej kryesisht në teorinë dhe praktikën e Stalinit. Udhëheqja e Tiranës, pas Kongresit 20-të të PKBS filloi të ftohej në marrëdhëniet me Moskën, të

kundërshtonte platformat reformuese që sugjeronte Hrushovi dhe të mos pranonte ndryshimet në udhëheqjet e pas Luftës së Dytë dhe të vijonte kursin Stalinist më shumë se atë liberal të brendshëm të Hrushovit.

Duke pasur parasyshë që Hurovski u mundua që ta ndryshonte ideologjinë politike të Titos dhe politikave Jugosllave, ai realisht mundin e vet e bëri realitet dhe e konvertoi politiken Jugosllave në të tillë si anti staliniste, pasi që dhe vet Tito preferoi të jetë anti stalinisti i parë. E gjithë kjo ishte politikë e kundërt me politikën shqiptare, veqanërisht me kontaktin e mirë të Moskës. Konflikti ideologjik përfshiu çështje të teorisë dhe të praktikës së revolucionit siç ishin debatet për luftën dhe paqën, për bashkë ekzistencën paqësore dhe për Stalinin dhe rolin e tij. Konfliktit ideologjik ishte në mosperputhje dhe mjaft problematik në marrëdhënie me planin politik dhe shtetëror, ndërsa në planin praktik këta të lartpërmendurit u ballafaquan me konflikte të cilat rrodhën si pasojë e mosmarrëveshjeve shqiptare dhe jugosllave. Edhe më tutje mosmarrëveshja mes Enverit dhe Hrushovit vazhdoi me përplasje të hapura në vitin 1960 në Bukuresht dhe gjithashtu kjo situatë vazhdoi edhe në mbledhjen e 81 Partive Komuniste në Moskë, në po të njëjtin vit.

Ndërkohë që acarimet nga dy palët shqiptare dhe sovjetike po ngriheshin, Tirana filloi lëvizjen e kursit të saj ideologjik e politik, në mënyrë të matur dhe jo shumë publike me Partinë Komuniste të Kinës dhe Kinën e Mao Ce Dunit. Enver Hoxha kishte kalkuluar mjaftë mirë rrezikun dhe kufirin deri ku mund të shkonin marrëdhëniet me Moskën ndaj kërkonte rrugë dalje ndërkombëtare paraprake. Kjo diktonte rrugën drejt Kinës së largët.

Nga viti 1956 filloi lëvizja drejt Kinës Komuniste, ndërsa shqiptarët dinin pak për Kinën dhe Mao Ce Dunit deri atë kohë. Moska kishte centralizuar gjithçka të botës komuniste. Pas vdekjes së Stalinit, Mao Ce Duni mbetej lideri komunist më i madh dhe kontribonte aq shumë ndaj nuk mund të pranonte kultin ndërkombëtarë të Hrushovit, i cili i a rrezikonte Kinën dhe monopolizimin e lëvizjes komuniste ndërkombëtare në Kremlin.

Këto arsye nxitën procesin e çarjes së botës komuniste në dy qendra. Atëhere edhe filloi të dobësohej fuqia e komunistëve në gjithë botën. Enver Hoxhëa manipuloi mjaft me shkathësi këtë ndarje të madhe mbarë komuniste për t'i paraprirë rreziqeve që mund t'i vinin Tiranës nga prishja me Bashkimi Sovietik.

Andaj lirisht mund të thuhet se nga viti 1956 dhe në vijim politika e Tiranës ndaj dy qendrave të mëdha të komunizmit botërorë filloi të dyzohet, duke reduktuar bashkëpuniumin ideologjiko-politik me Moskën dhe duke fuqizuar gradualisht bashkëpunimin politiko-ideologjik me Kinën. Brenda asaj ideologjie e politike të komunizmit botërorë kjo mund të konsiderohet si një manovër diplomatike rrugëdalëse për regjimin e Tiranës.

Kreu III

Shqipëria dhe Marrëdhënjet Ndërkombëtare

3.1 Marrëdhëniet e Shqipërisë me Fqinjët (1944-1961)

Politika e jashtme e regjimit komunist dhe marrëdhëniet me fqinjët në fazën e parë pas Luftës së Dytë Botërore ishin në nivelet më të ulta që nga Lufta e Parë Botërore. Kjo jo vetëm për fragmentarizmin gjeopolitik që përfshiu Ballkanin gjatë Luftës së Ftohtë, që analizuar më lart, por edhe për vetë problemet dypalëshe që pati Shqipëria me fqinjët tokësorë të saj.

Me Jugosllavinë marrëdhëniet pas 1948 nuk u normalizuan asnjëherë dhe nuk u balancuan në asnjë rrethanë në të gjitha fushat. Sidomos pas krizës shqiptaro-jugosllave 1947-48, krizës iu shtuan edhe problemet që pasuan zhvillimet me shqiptarë në Kosovë edhe në vise të tjera.

Pasi që keto marrëdhënie nuk u stabilizuan asnjëherë, Rankovici aso kohe vendosi që ta riste represionin mbi popullin shqiptar. Edhe pse regjimi i Tiranës pas 1948, derisa ra klika e Rankovicit, ndoqi politikën e heshtjes së madhe ndaj Kosovës dhe çështjes shqiptare në Jugosllavi, ai gjithashtu e reduktoi luftën me Jugosllavinë vetëm në plan ideologjik e propogandistik. Në rrafshin ekonomik, marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave erdhën duke u normalizuar.

Ndërsa me Greqinë dekada e parë e pas Luftës së Dytë Botërore prodhoi krizën më serioze shqiptaro-greke. Deri në vitin 1955, kriza arriti deri në konflikte ushtarake, siç ishin ato në verën e vitit 1949. Palët u ndeshën me armë në kufirin jugorë midis Korçës dhe Kosturit.

Si fillim shqiptarët akuzuan qarqet greke për shtypjen e çështjes së Çamërisë, ku dhe kjo ishte e para dhe e fundit herë që ngrihet kjo çështje ndërkombëtarisht nga regjimi i Enver Hoxhës në Konferencën e Paqes 1946. Ndërsa më vonë E. Hoxha e akuzoi Greqinë për provokim serioz të tërësisë territoriale të vendit. Pala greke akuzoi Shqipërinë për ndërhyrje në punët e brendshme, për mbështetje të guerrillasve komuniste greke, për pajisje të tyre me armë e municione dhe për krijimin e zonave mbështetëse dhe tërheqëse të tyre të Shqipërisë gjatë fazës së parë të luftës civile në Greqi. Madje, pala greke e ngriti çështjen në Kombet e Bashkuara dhe OKB miratoi rezolutën kundër Shqipërisë, e cila aso kohe akoma nuk ishte anëtare e Organizatës.

Në mbështetje të Shqipërisë qëndronte deri në 1948 edhe Jugosllavia dhe Bashkimi Sovjetik. Ndërsa pas 1948, vazhdonte të ishte vetëm Bashkimi Sovjetik në mbështetje të Shqipërisë sepse SHBA dhe Britania e Madhe atëherë qëndronin në mbështetje të Greqisë.

Situata e marrëdhënieve shqiptaro-greke filloi të normalizohet vetëm pas vitit 1955, kur Shqipëria u pranua anëtare e Kombeve të Bashkuara. Natyrisht, normalizimi nuk ndryshonte thelbin armiqësorë të marrëdhënieve, por krijuan një lloj kompromisi të heshtur dypalësh. Ky lloj kompromisi u formalizua me një sërë marrëveshjes tregtare, ekonomike dhe solli përmirësime edhe në qëndrimin sidomos të palës shqiptare ndaj pakicave greke në Shqipëri. Ndërsa Greqia vijoi të heshte dhe të injoronte plotësisht ekzistencën e pakicave shqiptare dhe të çështjes së Çamërisë dhe të çamëve. Mund të thuhet se, e vështruar në tërësi, politika shqiptare ndaj Greqisë gjatë regjimit komunist vuajti dukshëm nga inferioriteti dhe u karakterizua nga pasiviteti. Ndërkohë tensionet e brendshme ngeleshin rreziqe potenciale për kohët që do pasonin.

Marrëdhëniet e Shqipërisë me Bullgarinë e Rumaninë ishin të vendosura kryesisht në kuadër shumëpalësh, por ato zhvilloheshin edhe në mënyra dypalëshe. Përgjithësisht marrëdhëniet e Shqipërisë me këto vende satelite të Moskës vijuan të ndjekin mekanikisht trajektoren e marrëdhënieve të Tiranës me Moskën. Kuptohet që eurolindorët nuk kishin sovranitet të plotë për të përcaktuar në mënyrë të pavarur politikën e tyre të jashtme.

Midis Shqipërisë dhe Turqisë marrëdhëniet në fazën e parë të pas Luftës së Dytë Botërore njohën një zhvillim normal. Ndonëse Turqia u orientua drejt NATO-s, ky fakt nuk u reflektua dukshëm në marrëdhëniet dypalëshe. Por, duhet theksuar se bashkëpunimi mbeti më shumë politiko-diplomatik sesa i konkretizuar në fushat të tjera si ekonomia, tregtia, shkenca, kultura e teknologjia. Turqia mbetej si një lloj balancuesi Rajonal për Shqipërinë midis Greqisë dhe Jugosllavisë, si dhe një mbështetje morale e politike në kushtet e izolimit Rajonal të vendit dhe si një partner diplomatik në aspektin e politikës së jashtme.

Ndër fqinjët, Italia ishte vendi Perëndimorë me i afërt me Shqipërinë. Menjëherë pas Luftës u normalizuan marrëdhëniet diplomatike. Republika Italiane njohu dëmet e bëra ndaj Shqipërisë, andaj në përputhje me vendimet e Konferencës së Paqes, i pagoi Shqipërisë reparacionet përkatëse të luftës.

Duke njohur idetë e atë herëshme të Shqipërisë dhe Liderit të saj ,raporti politik mes Shqipërisë dhe Italisë nuk qëndronte fare mirë. Arsyeja pse ata shquheshin si kundërshtarë politik e ideologjik i pakompromis ishte sepse Italia ishte orientuar drejt NATO-s dhe sidomos drejt Shteteve të Bashkuara të Amerikës.Andaj gjatë luftës së ftoftë këto dy shtete nuk patëm bashkupnim të mirëfilltë.

Vatikanin filloi që të kishte ndikim rreth paragjykitimit të regjimit Stalinist dhe të Hoxhës, andaj ky opinion ndikoi në publikun Italian mjaftë shumë, duke pasur parasyshë rendësinë e Vatikanit për popullin Italian. Shqipëria Enveriste mbante qëndimre armiqësore me Vatikanin, Hoxha gjithashtu parapëlqeu te nënshkruante dokumente të cilat verifikojne mos bashkëpunimin në mes këtyre dy shteteve, që mos të ngjallty dyshime për bot.

3.2 Marrëdhëniet e Shqipërisë me Evropën Lindore

Në vitin 1961, Shqipëria dhe politika e jashtme e saj, filluan të merrnin qëndrime ndaj Evropës Lindore brenda kornizave të përcaktuara ndaj Moskës. Ishte një politikë në Bllok. Nuk kishte ndonjë trajtim individual. Kjo buronte nga vetë struktura e Bllokut Lindorë, ku edhe centralizimi i Moskës, sidomos për politikë të jashtme, politikën e sigurisë dhe politikën ekonomike kushtëzoheshin nga centralizimi i fortë i Kremlinit.

Austria, doli më ndryshe nga se nënshkroi Paktin Dypalësh me Moskën në vitin 1955 dhe më pas me Finlandën, që ndoqi të njëjtën rrugë me Austrinë, gjithë vendet e tjera Euro Lindore deri në vitet '80 ndoqën rrugën satelitore ndaj Moskës.

Gajtë viteve të 1947 e deri më 1968, apo ato vitet ku Jugosllavia, Hungari dhe Polonia e atëherëshme ishin drejt zhvillimit, mirepo keto shtete nuk pajtoheshin dot që Moska të ketë sundim të plotë mbi to dhe ato të ishin të sunduar gjithëmonë nga Moska. Ato vetëm atëherë patën guximin që të panojnë hapur që Moska i sundonte vetëm me dhunë, forcë dhe kërcënim. deri në vitin 1960 Shqipëria trajtohej si anëtare me të drejta si të tjerët, merrte pjesë në programe ndihme e zhvillimi, ishte e vlerësuar politikisht e diplomatikisht prej tyre, pas prishjes me Bashkimin Sovjetik, marrëdhëniet e Shqipërisë me këto shtete Euro Lindore u reduktuan vetëm në ato fusha e sektore që lejoheshin nga Moska, nga Traktati i Varshavës dhe KNER-i. Pra ishte një kuadër i përcaktuar dhe i limituar bashkëpunimi.

Pas viteve 60-të vendet Euro Lindore e stigmatizuan Shqipërinë si vend izolacionist e Stalinist, ndërsa Shqipëria i stigmatizoi ato si satelite revizioniste të Bashkimit Sovjetik. Ideologjikisht bashkëpunimi u ndërpre me prerjen e marrëdhënieve me Moskën. Politikisht ngelen të vijojnë vetëm marrëdhëniet shtetërore, jo ato partiake. Ushtarakisht, marrëdhëniet

u ndërpre në me përzënien nga Shqipëria të Bazës Ushtarake të Vlorës. Ekonomikisht bashkëpunimi vijoi mbi baza dypalëshe, jo të KNER-it dhe mbi fusha e sektore me interes reciprok.

3.3 Marrëdhëniet e Shqipërisë me Perëndimin

Regjimi Enverist i Tiranës pas Luftës së Dytë Botërore deri në Konferencën e Paqes në Paris (1946) u duk se do mbante qëndrim konform politikës së aleancës së madhe të Luftës. Kjo u duk në fjalimin që Enver Hoxha mbajti me rastin e vdekjes së Ruzveltit ku ngriti lart jo vetëm rolin e tij, por vlerësoi shumë edhe SHBA-të. Edhe me Britaninë menjëherë pas Luftës pati një lloj dëshire për vijim marrëdhëniesh. Por, kjo tendencë ishte vetëm e përkohshme.

Shkaku kryesorë që SHBA dhe Britania e Madhe mbajtën qëndrim armiqësorë të hapur ndaj Qeverisë Enveriste së Tiranës lidhej me tre shkaqe:

Së pari, SHBA dhe Britania kërkuan që të vijoheshin gjithë traktatet dhe marrëveshjet dypalëshe që regjimi i Mbretit Zog I dhe këto dy Fuqi perëndimore kishin firmosur përpara Luftës së Dytë Botërore. Shqipëria këtë nuk e pranoi, sepse e ishte hedhur poshtë së bashku me të drejtën e kthimit të Mbretit Zog I në Shqipëri sipas vendimiti cili ishte marrë në Kongresin e Permetit që u mbajt më 24 maj 1944.

Së dyti, SHBA dhe Britania e Madhe kërkuan që në Shqipëri të bëheshin zgjedhje të lira e demokratike sipas marrëveshjes së Jaltës për gjithë Evropën Lindore. Ata kërkonin një Qeveri legjitime si kusht për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Tiranën. Mirëpo zgjedhjet në Shqipëri, në vitin 1945, jo vetëm u manipuluan masivisht nga komunistët, por edhe u kontestuan fuqishëm nga forcat opozitare të kohës së atëherëshme. Kjo u kritikua mjaft shumë nga SHBA dhe Britania e Madhe.

Së treti, midis Shqipërisë dhe Britanisë kishte ndodhur aksidenti i Korfuzit në përfundim të Luftës së Dytë Botërore, ku kishin humbur jetën disa ushtarë Britanik. Britania e Madhe e hodhi këtë rast në Gjykatën Ndërkombëtare dhe e fitoi atë. Gjykata e penalizoi Shqipërinë me rreth 800 mijë dollarë amerikanë gjobe. Këtë gjobë Qeveria komuniste kurrë nuk e pagoi. Si reagim, pala Britanike refuzoi kthimin e arit shqiptarë të grabitur nga nazistët, të kapur prej Britanikëve. Kështu konflikti shqiptaro-britanik u komplikua edhe më shumë.

Gjatë viteve 1944-1955, Britanikëve dhe Amerikanët bënë plane së si do t'i a bënin që ta ndryshonin mënyrën e qeverisjes në Shqipëri apo të themi regjimin Enverist. Për këtë kishte projekte që të mbështeteshin forcat opozitare brenda vendit, të cilat kishin humbur në zgjedhjet fallco që i kishin organizuar shteti Shqiptarë, dhe përveç tjerash Regjimi Komunist në krye me Hoxhën nuk njihte kufinjë në eliminimin e njerëzve të cilët edhe mund ti pengonin në planet e tij. Andaj SHBA-të dhe Britanikët donin domosdoshmërisht t'i përkrahnin forcat opozitare. Ata gjithashtu bënë plane të mbaheshin lidhje me mërgatën shqiptare sidomos me Mbretin dhe me Mi'that Frashërin si dhe të organizoheshin edhe aksione spiunazhi për përmbysje me forcë. Fatkëqësisht këto plane u zbuluan nga Moska.

Ndonëse nuk u vendosen asnjëherë marrëdhënie diplomatike midis Shqipërisë dhe SHBA dhe Britanisë së Madhe, këto dy fuqi nuk u bënë më pengesë që edhe Shqipëria të bëhej anëtare e OKB në vitin 1955.

Kreu IV

Diplomacia Shqiptare

4.1. Shqipëria, diplomacia shumëpalëshe dhe Organizatat Ndërkombëtare

Pas viteve të 50 Shqipëria filloi të gjallërohet me pjesëmarrjen në diplomacinë shumëpalëshe dhe në disa Organizata Ndërkombëtare.

Deri në vitin 1955, Shqipëria ishte pjesëtare e dy organizatave të Evropës Lindore: e KNER-it dhe e Traktatit të Varshavës.

KNER-i ishte organizatë me profil ekonomik. Atë kohe Shqipëria bashkëpunoi me KNER-in si organizatë dhe me shtetet anëtare individuale. Përfitimi nga KNER-i ishte i konsiderueshëm vetëm në periudhën e viteve '50-'60. Luhatjet dhe sidomos krizat në mes shqiptarëve dhe sovjetikëve do reflektoheshin direkt në pasojat e bashkëpunimit të Shqipërisë me KNER-in.

Traktati i Varshavës ishte një organizatë me profil ushtarak. Shqipëria ishte anëtare e Traktatit qysh në themelimin e tij ndërsa qëllimi i Traktatit të Varshavës ishte si pol i kundërt i NATO-s dhe si kundërvënie ushtarake ndaj Aleancës. Shqipëria pati bashkëpunuar me organizatën në tërësi dhe me shtetet anëtare individuale të Traktatit të Varshavës.

Një histori të veçantë dhe të komplikuar patën marrëdhëniet e Shqipërisë me Kombet e Bashkuara. Shqipëria aplikoi për anëtarësi në Organizatë qysh në vitin 1945. Mirëpo kërkesa e saj nuk u pranua dhjetë vjet radhazi.

Politika dhe propoganda shqiptare e kohës e arsyetonte këtë me qëndrimin armiqësorë të SHBA dhe të Britanisë së Madhe kundër Shqipërisë. Mirëpo studimet e materialeve të kohës në kancelaritë e Fuqive të Mëdha dhe në dokumentat e Organizatës për periudhën 1945-55 vërtetojnë se këto arsyetime politike e propogandistike të Tiranës asokohe nuk kanë baza reale.

E vërteta është se bllokimi i Shqipërisë ishte pjesë e bllokimit të anëtarëve të reja në Organizatë për shkak të konfliktit serioz të dy superfuqive që ishin Bashkimi Sovietik dhe SHBA për të vendosur kontrollin suprem mbi Organizatën, duke shtuar për këtë qëllim secila palë mendohej që të antarësonte palë përkrahese të tyre.

Pas kalimit të kësaj krize, u arrit në kompromisin historik që secila palë të propozonte një grup-shtetesh të barabarta mbi parimin e paritetit për t'u pranuar në vitin 1955. Me këtë kompromis ndërkombëtarë dhe në grup me disa shtete të tjera u pranua edhe Shqipëria.

Arsyeja e vonesave të pranimit të Shqipërisë në OKB nuk ka patur një qëndrim individual diskriminues nga Fuqitë Perëndimore, por ka qenë proces i bllokuar nga dy Superfuqitë e mëdha të cilat dominim mbi Organizatën. Shqipëria ishte vetëm pjesë e krizës së dy Superfuqive, BS dhe SHBA brenda Kombeve të Bashkuara në dekadën e parë të Luftës së Ftohtë.

Nga viti 1955, Shqipëria u bë anëtare e Kombeve të Bashkuara dhe ka dhënë ndihmesë pozitive në kuadër të Organizatës për gjitha aspektet e veprimtarisë së saj. Kombet e Bashkuara janë e vetmja organizatë ndërkombëtare ku bëri pjesë aktive Shqipëria gjatë periudhës pas prishjes me Bllokun Komunist Lindorë deri në vitet '90.

4.2 Problemet shqiptaro-sovjetike deri te prishja e marrëdhënieve diplomatike

Në mes të viteve të 60-ta, marrëdhëniet Shqiptare me Sovietikët u përkeqësuan dukshëm. Në këtë kohë ndaheshin në mes dy blloqeve ,apo më mirë të themi qendra të mëdha komuniste, ato ishin Bashkimi Sovietik dhe Kina.

Kriza u reflektua sidomos në rastin e krizës së Berlinit dhe krizën e raketave në Kube. Në këto dy momente kulmore ndodhen edhe dinamika politike brenda të dy Blloqeve. Blloku Perëndimorë filloi ta implementoj fuqishëm Planin Marshall në praktikë dhe duke fuqizuar NATO dhe programet e strategjitë e saj, ndërsa Blloku Lindorë erdhi duke u dobësuar, duke u ndarë në dy qendra globale-Moskë-Pekin

Sidoqoftë piku arriti në kohën Kenedi-Hrushov, që të dy superfuqitë e kuptuan se nuk mund të ecnin më ekstremisht pa shkuar në luftë direkte. Balancimet ishin të dukshme në të gjitha aspektet. Lufta do shkatërronte gjithë botën e në radhë të parë dy Fuqitë e Mëdha. H.Kisingjer citon mjaft mirë¹

“Nëse diplomacia pengohet nga përcaktimi i qëllimit të luftërave, atëherë çdo konflikt do të shëndrohet në luftë”

¹Henry Kissinger, Simon & Schuster, 1994, 912 pg.

Me fjalë të tjera Kissinger potencon që²:

“ Edhe gjeniu më i madh ushtarak është i pavlefshëm, pa një diplomat pas tij për të përcaktuar qëllimet e luftës “

Në këtë periudhë krize globale dhe sidomos të fragmentarizmit brenda bllokut komunist, Shqipëria e thelloi krizën e marrëdhënieve dypalëshe me BS. Kriza filloi në planin ideologjik e politik vetëm partiak dhe në fund të viteve '50 filloi të shëndërrohej në krizë shtetërore dhe përfshiu edhe fushat e tjera politike, diplomatike, ekonomike, ushtarake dhe kulturore.

- Në ideologji bazë u bënë tezat kryesore të Kongreseve mbi luftën e paqen, mbi bashkëzistencën paqësore dhe mbi Stalinin;

- Në ekonomi bazë u bënë tezat e Hrushovit për zhvillimet e prioriteteve të ekonomisë shqiptare pa industri të rëndë;

- Në diplomaci bazë u bënë qëndrimet e Moskës për të kontrolluar politikën e jashtme dhe diplomacinë shqiptare, rehabilitimi i Jugosllavisë nga Hrushovi, si dhe lëvizja e diplomacisë shqiptare drejt Kinës së Mao Ce Dunit;

- Në ushtri bazë u bënë konflikti për armatimin e vendit dhe modernizimin e ushtrisë si dhe më pas Baza a Vlorës në Pasha Liman.

²Henry Kissinger, Simon & Schuster, 1994, 912 pg.

Kriza shqiptaro-sovjetike filloi ngritjen e shpejtë në Bukuresht 1960 në prag të Mbledhjes së Moskës të po atij viti. Kriza kulmoi në Mbledhjen e 81 Partive Komuniste e Punëtore në Nëntor, Moskë 1960.

Në atë mbledhje kontradiktat dypalëshe shqiptaro-sovjetike u shpalosën ndërkombëtarisht dhe morën karakter dhe dimension multilateral. Shumë faktorë dhe aktorë u përfshinë në atë krizë. Pjesa dërmuese ishin vasale ideologjike e politik të Moskës. Vetëm delegacioni i Kinës dhe disa partitë tjera Komuniste Perëndimore mbështetën direkt ose indirekt platformën e delegacionit shqiptarë.

Ndërkohë, diplomacia shqiptare në atë Mbledhje u pozicionua haptazi në favor të qëndrës së dytë të komunizmit botërorë: Kinës së Mao Ce Dunit. Ky qëndrim madhorë ishte plotësisht kundër interesave të Moskës dhe kundër platformës së përbashkët Eurolindore.

Kjo mjaftoi që Hrushovi në vitin 1961 të ndërpriste në mënyrë të njëanshme marrëdhëniet diplomatike me Shqipërinë. Ishte rasti i parë dhe unik që Bashkimi Sovjetik do të bënte në këtë mënyrë me një vend Eurolindorë. Mendohet se Hrushovi gaboi dhe u nxitua duke ndërprerë marrëdhëniet në nivel diplomatik me Shqipërinë, pasi këtë gjë që nuk e pati bërë as me armiqtë më të egër të BS dhe të Bllokut Lindorë. Por, ka edhe mendime se e bëri për presion preventiv për anëtarët e tjerë të Bllokut Eurolindorë që kishin tendenca separatiste, si mësim tregues për të tjerët dhe të parandaloj që ndoj shtet tjetër ti vihet kundër. Në këtë aspekt ndëshkimi i Shqipërisë i shpërbeu interesave të BS.

Pas prishjes së marrëdhënieve diplomatike mes Shqipërisë dhe Bashkimit Sovjetik, rruga e Shqipërisë drejt Kinës ishte e hapur.

Ky hap shënon një fazë të re për politikën e jashtme dhe diplomacinë shqiptare gjatë Luftës së Ftohtë.

Kreu V

Diplomacia shqiptare dhe Lufta e Ftohtë

5.1. Faza e fundit e Luftës së Ftohtë

Në fund të viteve të 70-ta përfundoi edhe periudha e Luftës së Ftohtë. Dy bloqet kryesore të Luftes së Ftohtë filluan të konfrontoheshin përsëri. Dhe në aspektin e planit botëror edhe kjo periudhë karakterizohet me disa fenomene të cilat kanë prekur këto dy blloqe.

5.2. Doktrina e Regan-it

Në Uashington vjen President, republikani R. Regan, i cili përgatiti dhe e filloi zbatimin e strategjisë ofensive kundër komunizmit dhe posaqërisht Bashkimit Sovjetik.

Natyrisht, perandoria sovjetike nuk kishte pasur luftë në kuptimin klasik të kësaj fjale, por ajo ishte përballur me luftë të ftohtë për afro gjysmë shekulli, luftë në të cilën ishin ndeshur herë heshturazi herë haptazi vlerat, interesat, sistemet, gjeopolitikat dhe aleancat e blloqet midis dy botëve krejtësisht të ndryshme: kapitalizmi dhe komunizmi.

Lufta e Ftohtë, ndryshe nga luftërat klasike kishte sjellur degradimin gradual të perandorisë sovjetike, kishte provokuar energjite e brendshme, kishte konsumuar pak nga pak resurset ekonomike e teknologjike, kishte brejtur ngadalë gjithë strukturat e sistemit të brendshëm dhe të aleancave satelitore të jashtme.

Natyrisht, pavarësisht nga degradimi i brendshëm dhe i aleancave, komunizmi nuk mund të binte nëse nuk do i kundërvihet një doktrinë e fuqishme perëndimore. Këtë doktrinë e paraqiti dhe e zbatoi R. Regan, Presidenti Amerikan i viteve '80-të.

Doktrina e Reganit u paralajmërua në fillimet e viteve '80-të nga Sekretari i Shtetit, Aleksander Heig

Në zbatim të kësaj doktrine administrata e Reganit përqëndroi maksimalisht energji të jashtëzakonshme politike, diplomatike, ekonomike dhe ushtarake si dhe gjithë faktorët dhe aktorët e mundshëm ndërkombëtarë për realizimin e “shërimit”, që do të thoshte shembja e komunizmit si sistem botërorë dhe e Bashkimit Sovjetik si qendër e tij.

Për realizimin e Doktrinës së tij, Regani përdori katër komponente të rëndësishme:

- negociatat në nivelet më të larta;
- vlerat e demokracisë amerikane;
- veprimet në arenën ndërkombëtare;
- fuqizimin ushtarak dhe përmirësimin strategjik amerikan dhe euro-atlantik;

Komponenti i parë:

Bisedimet mes Regan dhe Gorbacov përfshinë gjithë fushat dhe tërë aspektet dypalëshe dhe shumëpalëshe globale.

Komponenti i dytë:

U përdorë ballafaqimi i vlerave në të gjitha nivelet dhe në të gjitha fushat e jetës së brendshme dhe ndërkombëtare.

Komponenti i tretë:

Shënonte një kthesë të plotë nga relaksimi pacifist i marrëdhënieve në strategjinë ofensive kundër komunizmit botëror dhe Bashkimit Sovietik.

Komponenti i katërt:

Përbënte në fakt hallkën përfundimtare, atë të fuqizimit ushtarak maksimal Amerikan, pa iluzionet e administratës së Karterit, dhe hedhjen në strategji ofensive për çdo rast të mundshëm.

Doktrina e Reganit u hodh në veprim anë e kënd botës. Në dy raste ajo merret si model ekstrem, i mos suksesit dhe i suksesit. Në Nikaragua, Doktrina e Reganit nuk konsiderohej e suksesshme për hedhjen në erë me forcë të regjimeve me ndikim komunist e influencë sovjetike, ndërsa në Afganistan, Doktrina e Reganit u tregua e suksesshme sepse solli kapitullimin fatal të potencialit për strategjinë sovjetike në Lindjen e Mesme.

Si përfundim mund të thuhet se Doktrina Regan afrimoi ndërkombëtarisht vlerat dhe kapacitetet e SHBA-se mbi BS dhe të demokracive Perëndimore mbi sistemin sovjetik të Evropës Lindore .

5.3. Doktrina Gorbacov

Ndryshimet e sistemit të marrëdhënieve ndërkombëtare të Luftës së Ftohtë nuk mund të bëheshin në të njëjtën kohë, deri sa kohe që vetë sistemi bazohej në ekzistencën dhe në rivalitetin e dy poleve. Në këto rrethana do të ishte me shumë rëndësi, madje domosdoshmëri edhe evoluimi politik brenda polit tjetër të botës, polit komunist, sidomos brend BS.

Vdekja e Brezhnjevrit në 1982 krijoi kaos në kreun e Kremlinit dhe pasiguri ndërkombëtare. Andropovi dhe Cernjenko, dy liderë të vjetër që e pasuan Brezhnjevin vdiqën shpejtë pa u ndier në jetën politike sovjetike e globale. Më së fundi, pas kaq kohësh, erdhi në Kremlin një liderë me vizione krejtësisht të ndryshme nga paraadhësit e tij dhe ai ishte Mihail Gorbacov.

Gorbacov kishte lindur në Kaukazin e Veriut në vitin 1931. Mbaroi studimet për bujqësi. Punoi shumë vite me rininë komuniste. Në vitin 1979 u zgjodh kandidat i Byrose Politike.

Me të ardhur në Kremlin, Gorbacovi parashtriu Doktrinën e tij, e cila përmbante dy kolona: Perestrojken dhe Gllaznistin.

Perestojka përmbante programin e ristrukturimit ekonomik dhe politik të BS. Baza qëndronte në uljen e shpenzimeve ushtarake dhe rritjen e investimeve në ekonomi. Reduktimi i administratës dhe lufta kundër korrupsionit të madh. Reforma do përfshinin edhe Partinë si dhe marrëdhëniet ndërtenike.

Gllaznisti përmbante programin e realizmit të transparencës, të hapjes së politikës e shtetit, partisë e institucioneve të larta në të gjitha nivelet përballë popullit, opinionit qytetarë dhe medias.

Por, Doktrina e Gorbacovit, pati dobësi e kontradikta të mëdha.

Së pari, Gorbacovi asnjëherë nuk e bëri të qartë vizionin e reformave të tij për popullin, për Partinë e tij, për mbarë botën ku aiu presentua. Ai kërkonte të ringrinte BS në nivele të shteteve ekonomikisht më të zhvilluara, por si do ta bënte këtë ai apo se si dhe kur ,ai asnjëherë nuk e qartësoi

Së dyti, Gorbacovi kërkonte të bënte sistem ekonomik të ri dhe ta ndyshonte sistemin ekonomik të vjetër të tipit sovjetik.

Së treti, Gorbacovi me reformat e tij u hapi rrugë liderëve të republikave për ide, vizione e alternativë të reja, të cilat do binin ndesh synimit të tij për ruajtjen e Bashkimit Sovjetik, por mbi bazën e Bashkimit të Republikave Socialiste Sovrane. Ky projekt nuk u realizua asnjëherë sepse ishte kontradiktore. BS dhe sovraniteti i republikave nuk pajtoheshin dhe siç do të ndodhte në fakt, do provokonte të kundërtën e asaj që synonte Gorbacovi.

5.4 Evropa Perëndimore

Ndryshime ndodhin edhe në Evropën Perëndimore gjatë viteve '80-të. Me rëndësi në këtë fazë është iniciativa Gensher-Kolombo, dy ministrave të jashtëm të Gjermanisë dhe të Italisë, që paraqiten në fund të vitit 1981 në “Aktin Evropian” që ishte thelbi i iniciativës Gensher-Kolombo.

Ky Akt synonte forcimin e Komunitetit Evropian, duke synuar edhe bashkimin në politikën e jashtme dhe në atë të sigurisë. Ky Akt do shqyrtohej pesë vjet pas hyrjes në fuqi dhe do të përbënte themelet e ardhshme të Bashkimit Evropian.

Fillimisht u kundërshtua nga Britania e Madhe, Akti sërsih arriti të miratohej në vitin 1983 në Shtutgard në trajtën e një dokumenti që do njihet ndërkombëtarisht si “Deklarata Solemne mbi Bashkimin Evropian”.

Ndryshimi midis Aktit Gensher-Kolombo dhe Deklarates Solemne qëndronte në faktin se kjo e dyta heq referencat për një traktat themelues të Bashkimit Evropian, që do të thotë; kufizon kompetencat shtesë për institucionet Evropiane dhe atë të heqjes të së drejtës së vetos në procedurat vendim-marrëse të Komunitetit Evropian.

Në këtë periudhë në Evropë vijnë disa propozime duke përfshirë projektin për Traktatin Spineli, propozimet e Miteranit për mosmarrëveshjet dhe vijimin e reformave drejt Bashkimit Evropian, paketën e Komitetit Dag, të propozuar nga Ministri Jashtëm Irlandez, Xhejms Dag për rritjen e rolit të Parlamentit Evropian, të Komisionit të Politikës së Jashtme dhe ndarjen e vendim-marrjes Parlament-Këshill Ministrash për buxhetin dhe funksionimin e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë.

Pas këtyre propozimeve vijnë radhazi:

- projekti i Kryeministres Britanike, Margret Thecerit, “Evropa - E Ardhmja” ;
- katër propozimet franceze për “Evropa teknologjike”, “Evropa e Qytetarëve”, “Evropa ekonomike e sociale”, “Bashkimi Evropian”;
- projekti franko-gjerman Miteran-Kohl;
- “Libri i Bardhë”, i Lord Kokfild;
- U mbajt Konferencen e Luksemburgut 1985;
- U modifikua Traktati i Romës dhe dokumenti i përbashkët politik “Akti Unik Evropian”, që krijoi kryesisht tregun unik të brendshëm.
- Projekti i Zhak Delorit për bashkimin monetarë Evropian në shkurt 1988;

Pra vërehet faktorizim i fuqishëm Evropiano-Perëndimorë drejt tendencës për bashkim ekonomik, monetarë dhe në politikën e jashtme dhe të sigurisë. Evropa Perëndimore po përgatitej kështu për të dal si një fuqi globale pas përfundimit të Luftës së Ftohtë.

5.5.Evropa Lindore

Gjatë fazës së ri-konfrontimit edhe vendet e Evropës Lindore u përfshinë në procese evolutive interesante. Këto procese preknin aspekte teorike të marksizmit, të socializmit dhe të ideologjisë përgjithësisht. Por, ato përfshinë edhe aspekte të politikave konkrete lidhur me sovranitetin në politikën e jashtme, me politikat ekonomike, me marrëdhëniet e shtetit me partitë komuniste, me reformat në të gjitha fushat e tjera.

Këto dukuri evolutive përfshinë gjithë vendet Eurolindore. Ndryshimi qëndronte në larminë, thellësinë, dimensione dhe dinamike.

Bullgaria i qëndroi më besnike modelit të komunizmit ortodoks sovjetik. Zhivkovi ishte mjeshtri fanatik i komunizmit bullgar, ai diti të thithë investime të konsiderushme dhe

siguroi gjatë gjithë kohës mbështetje të fuqishme të Moskës, për zhvillimin e vendit të tij në çdo aspekt.

Rumania nuk bëri ndryshime në politikat e brendshme të saj. Ceausescu u përpoq të forconte elementet të sovranitetit në politikën e jashtme .

Polonia, pas lëvizjeve të viteve '60 kishte arritur një pikë të tillë eksplozimi që do të shpërthente me lëvizje ideologjike të inspiruara nga inteligjencia dhe kleri katolik pas zgjedhjes së Papa Wojtilës në krye të Vatikanit, sikundër u përfshi edhe në lëvizje shoqërore të fuqishme Moska ishte shumë e kujdesshme ndaj Polonisë edhe për arsye gjeopolitike të saj.

Gjermania Lindore mbet një nga pjesët më fanatike të Moskës. Honekeri, lideri komunist gjermano-lindorë u qëndroi besnik Moskës. Vetëm nga mesi i viteve '80 Honekeri filloi komunikimet me Gjermaninë Perëndimore, përmes të cilave informonte për gjendjen e vështirë dhe për mundësi bashkëpunimi me Perëndimin. Sidoqoftë, në Gjermaninë Lindore, prania e lartë ushtarake, politike, ekonomike e e sigurisë së BS sillte impakte frenuese për çdo lloj procesi evolutiv Brenda atij shteti komunist.

Hungaria, e cila pas Revolucionit të '56 kishte përjetuar represion sovjetik të ashpër, nga vitet '80 filloi të bënte politikë me dy standrate: një për Moskën dhe një tjetër për veten e vet.

Kadari ishte komunist, por me liberal. Ai u tregua fleksibil si ndaj Kremlinit ashtu edhe ndaj popullit të vet. Kadari ndërtoi një diktaturë “të butë”, çka solli ndryshime liberalizuese evolutive në vend.

Jugosllavia, pas vdekjes së Titos vijoi sistemin e ndërtuar prej tij. Federalistët afro dhjetë vjet pas Titos i qëndruan atij modeli me pikëpamje liberale në ekonomi dhe jetën shoqërore, me orientime të hapura ndaj botës dhe me përfitime nga të dy Blloqet.

5.6.Shqipëria dhe politika e saj, pas prishjes së marrëdhënieve ekonomiko-ushtarake me Kinën

Gjatë viteve të 80 hasim në Shqipërinë pa asnjë mbështetje politike, ekonomike dhe ushtarake ndërkombëtare. Prishja e marrëdhënieve ekonomike e ushtarake me Kinën e kishte ekspozuar Shqipërinë krejtësisht të zbuluar ndaj rreziqeve që paraqiste faza e fundit e Luftës së Ftohtë, të pa mbuluar me ndihma e mbështetje ekonomike, të pambeshtetur politikisht e ideologjikisht nga asnjë fuqi e madhe apo e mesme komuniste.

Shqipëria po kalonte fazë të rëndë aso kohe. Mbyllja në vetvete, mbështetja vetëm në resurset e brendshme, gjeopolitika Rajonale armiqësore dhe vetë faza e rikonfrontimit të Luftës së Ftohtë po e bënte udhëheqjen shqiptare të përpunonte strategjinë e vet të vetëizolimit. Aso kohe Lideri Komunist Hoxha besonte se Shqipëria mund të eci vet dhe të mbrijë majat ai gjithashtu duke e parë situatën që çdo ditë e më tepër ishte vështërsuar, përpiloi testamentin i cili do i udhëzonte pas ardhësit e tij, pasi që Shqipëria vetëm kishte mbetur pa përkrahje të asnjë aspëkti. Ekonomikisht, Shqipëria ishte mjaftë e varfër për arsye të mos bashkëpunimit me fqinjët dhe shtetet të tjera. Populli ishte në krizë të madhe. Në aspektin e sigurisë dhe mbrojtës së Shtetit qëndronte edhe më keq, pa përkrahje dhe ndihmë, andaj Hoxha këtë periudhë e karakterizoi si mbroja e shtetit duhej të ishte detyrë mbi detyrë.

Testamenti i Hoxhës ngërthentë këto prioritete

Hoxha në testamentin e tij parashihte që jashta atyre ligjeve eksistuese për çështje ekonomike, të krijohëshin edhe ligjet sikurse ligji për mbështetjen plotësisht në forcat e vete dhe ligji për kursimin. Pse ndodhi kjo? Kjo ndodhi si pasojë e shaktuar nga mos përkrahja e superfuqive të asaj kohe të cilat ishin BS, SHBA-të dhe Kinën. Duke konsideruar që Shqipëria tani më ishte konvntuar në armike apo shtet jo favorit për këto vende, ajo u mbyll në vete dhe Lideri i vendit vendosi që të krijonte ligjin për kursim, nga i cili shteti nuk do

mbetej krejtësisht i varfër sa i përket anës financiare.Por këtë e vuajti populli i cili mbeti shumë i varfër nga vendimet e Hoxhës.

Në testament Enver Hoxha e shpallë mbrojtjen e Atdheut “detyrë mbi detyrat”. Mijëra bunkere, rrethuan me beton dhe armë Shqipërinë që në rast së dikush do e sulmonte të ksohin mundësi mbrojtjeje.Mirëpo i gjithë ky investim material e goditi vendin tmerrësisht dhe izoloi ekonominë,sepse keto ishin vetëm humbje materiale nga të cilat nuk përfitohej asgjë.

Sa i përket planit ndërkombëtar politik ai prioritzoi këto gjëra:

- Bbarazi ndërkombëtare;
- Respektim të sovranitetit shtetëror;
- Mosndërhyrjes në punët e brendshme;
- Bashkëpunimit me leverdi reciproke;
- Parimit të fqinjësisë së mirë;

Këto ishin vetëm disa nga prioritetet të cilat i caktoi Hoxha në testamentin e tij.Pas vdekjes së Enver Hoxhës, në Shqipëria filloi të frymojë ndryshe,më e qetë. Jo që jeta kishte ndryshuar shumë por mjafton që populli nuk jetonte më me presionin Enverist, këtë e potencoi edhe Bernd Fischer³

“Është e vëtrëtë që regjimi brutal i Hoxhës, tani më ka ikur,duke përfshirë: vetëizolimim e shtetit,vrasjet e shumta politike,burgjet politike,kampet e punës së detyruar dhe vështërsësitë e migrimit të brendshëm”

³.Bernd Fischer,Albania and Enver Hoxha's legacy,Open Democracy,June 201

Ramiz Alia vazhdoi rrugën e njëjt sikurse Hoxha në aspektin e udhëheqjes së shtetit, mirëpo ky i fundit ishte më liberal dhe fleksibil ndaj reformave të cilat kishin potenciale për ta avasuar Shqipërinë në platformën e Politikës Ndërkombëtare dhe zhvillimit të saj, mirëpo nuk bëri ndonjë hap të madh drejt progresit të Shqipërisë. Ramiz Alia u tërhoq nga jeta politike pa shkaktuar ndonjë problem dhe mjaft i qetë në fillim të 90-jetave pasi që ra Sistemi Komunist dhe fitoi Sistemi Demokratik.

Kreu VI

Diplimacia Shqiptare dhe Sistemi Demokratik

6.1 Zgjedhjet elektorale, PD -PS

Nga koha që Ramiz Alia kishte marrë udhëheqjen e shtetit Shqiptar në dore, jeta në Shqipëri i kishte marrë një frymë më të lehtë se sa gjatë kohës së regjimit Enverist. Në vitin 1992, u organizuan zgjedhjet elektorale, ku dh parti demokratike kishin marrë nën kontroll gjithë organizimin e zgjedhjeve, pasi që herën e fundit kur u organizuan zgjedhjet, Partia Komuniste me forcë morri meritat dhe përsëri u vetshpall fituese. Këtë herë jo vetëm Sali Berisha i cili ishte konkurent për President por edhe shumica e popullit Shqiptar ishin të lumtur për ndryshimet të cilat do të ndodhnin. Pas fitores së Berishës, Shqipëria ishte një shtet mjaft i varfër, populli kishte qenë me vite i mbyllur pa pasur mundësinë e shprehjes së lirë nga diktatori Hoxha. Gjatë këtyre viteve, vendi mori një atmosferë të re, populli më nuk punonte vetëm për shtetin por edhe për veten.

Kjo kohë përballi vendin edhe me disa transicione negative, sepse dëshira e të qenit udhëqës nuk i u nda as Socialistëve të cilët krijuan partinë Socialiste në krye me Fatos Nanon dhe Rexhep Meidani në vitin 1997.

Gjatë kësaj periudhe mjaft të rinjë emigruan për në vendet fqinje duke dëshiruar jetë më të mirë dhe politikisht më të qetë, pasi që kishin qenë dëshmitarë të një jete të mjerueshme të regjimit Komunist, dhe nuk donin që përsëri të kalonin në kriza dhe vështësi nga të cilat vetëm sa kishin dalur.

Partia Socialiste ishte në pushtet gjer në vitin 2005, kur fiton partia Demokratike dhe si Kryeministër të vendit shpall Sali Berishën.

Falë kësaj epoke, Shqipëria krijoi miq politik, hapi rrugë për ngritje ekonomike, hapi rrugë për bashkim të tregjeve me porte detare, të cilat u favorizuan nga Bashkimi Europian, ndërtoi infrastrukturë të re shtetërore, sjelli investitorë të huaj për ndërtim dhe investim në Shqipëri

dhe hapi vende të reja pune, konkretisht punoi drejt ndërtimit të një shteti të cilit do i hapeshin rrugët drejt Bashkimit Europian.

6.2. Fryma e re Diplomatike

Sali Berisha tani më e kishte të qartë se çka dhe se si donte ta shihte Shqipërinë, andaj nga minuti i parë i zgjedhjes së tij si Kryeministër kishtë filluar punën intensive për progresin politik, shtetëror dhe ekonomik të vendit.

Qëllimi i tij që Shqipëria të ishte anëtare e NATO-s kishtë filluar qysh në vitin 1992. Që nga ajo kohë ai kishtë bahskëpunim të mirë me NATO-n dhe qëllimi i tij ishte të demonstronte se Shqipëria kishte qënë viktimë e regjimit Komunist. Kjo ëndër e kahmotshme Berishase dhe Shqipëtare u bë realitet në vitin 2009 pasi që Shqipëria kishtë hyrë në planin përpartneritet të paqës të NATO-s qysh në vitin 1994.

Gjatë kësaj periudhe, Berisha dhe stafi qeverisës ishin mjaftë mirë të përgatitur sa i përket bërjes së Diplomacisë. Shqipëri është duke bërë progres falë frymës së re diplomatikë. Edhe pse politika Shqiptare po përballet shpesh herë me probleme të shahktuara nag Partia Socialiste e cila me çdo kusht don posht Sali Berishën dhe të arriturat e tij politiko-diplomatike, fatkeqësisht nuk po munden ta rrënojnë. Pas dorrëzimit të raportit të Shqipërisë në Bruksel për liberalizimin e vizave, aprovohet, dhe Shqipëria sot udhëton lirshëm sikurse vend i integruar në Bashkimin Europian.

Këto të arritura të fundit të shtetit Shqiptar janë falë frymës së re të Diplomacisë Shqipëtare dhe nga kjo Diplomaci shpresojmë të rezultojnë edhe hapa më të madha të cilat jo vetëm që inegrojnë Shqipërinë ne Bashkim Europian, por integrojnë atë drejt një jete paqësore, ekonomikisht stabile, me legjislacion mbi baza të drejtësisë dhe jo korupsionit

Konklusioni

Të bërit diplomaci apo të jeshë diplomat do të thotë të diësh të veprësh dhe presentosh në moment të duhur. Kur flasim për diplomatin, gjithëmonë kemi në mendje se po flasim për personin apo një grup të caktuar të personave të cilët përfaqësojnë politikën e shteti. Diplomacia njihet si profesion mjaft i vjetër qysh nga bërja e diplomacisë së Egjiptasve, Romakëve Grekëve etj. Qëllimi i diplomatëve ishte të ndërtonin politika të jashtëme të shteteve përkatëse ndër të cilat krijohet një bashkëpunim i ndërsjellë me ç'rast menagjohen konfliktet dhe evitohen luftërat politike, territoriale dhe ekonomike.

Diplomacia Shqiptare sikurs edhe diplomacitë të tjera e ka zanafillën e herëshme, njëjt sikurse edhe vendet të tjera, por se sa të sukseshëm ishin Shqiptarët në bërjen e diplomacisë ,mund të themi që ata ishin bashkëbisedues të mirë por jo negociator të sukseshëm.

Kur i bëjnë riciklim Historisë Shqiptare, dhe shohim se me çka është përballur Kombi Shqiptar, është mjaft e dhimbshme. Fillojmë që nga Ndarja e vilajeteve apo trojeve Shqiptare dhe dhurimi i tyre tek ata të cilët tutje edhe u shëndruan në armiq të përbetuar të këtij kombi. Pse ndodhi gjithë kjo ndarje e trojeve Shqiptare, fale kujt? Superfuqitë e mbledhura në Londër vendosën që most a përkrahin idenë për bashkimin e trojeve Shqipëtare, ata vendosën që vilajetët të ndaheshin. Shumë kush edhe mendonte së shteti i sapoformuar Shqiptar nuk do të munej të qëndronte në këmbë pasi që nuk njihej për shtet të fortë duke e pasur parasyshtë që ishte shtet i sapodalur nga lufta dhe i vetëshpallur i pavarur.

Gjatë kësaj periudhe populli Shqipëtar me shumë vështërsi mbijetoi dhe qëndroi si shtet i pavarur edhe pse i ndare. Pas Luftës së dytë Botërore shpallët edhe lideri Komunist Enver Hoxha i cili fillimisht ishte mjaft serioz në angazhimin rreth zhvillimit të shtetit shqiptar edhe në arenën ndërkombëtare. Enver Hoxha i lindur në Gjirokastër, dhe i njohur si President i Shqipërisë në krye me Partinë Komuniste, kishtë pikëpamje politike Staliniste dhe konsiderohej të jetë një Komunist i përbetuar.

Aso kohe Tirana që ishte qendra e shtetit Shqiptar krijoj marrdhënie të mira me Moskën. Edhe pse shumica e shteteve bashkoheshin ideologjisë politike Staliniste pa dëshirë dhe me dhunë, Hoxha i u bashkua me dëshirën më të mëdhe kësaj ideologjie. Falë bashkëpunimit të

ngushtë me Mosken,Shqipëria pati ca privilegje të caktuara apo thënë më mirë mbështetej në shumë aspekte nga superfuqia e atëhershme e Bashkimit Sovietik.Marrëdhëniet e mira mes Moskës dhe Tiranës zgjatën një kohë të gjatë. Enver Hoxha mbante takime të rregullta dhe në të njëjtën kohë edhe Shqipëria trajtohej mirë nga Stalini dhe regjimi i tij.Pas vdekjes së Stalinit vie Hurshovi në pushtet i cili dëshironte dhe ishte i prirur për reformat ë cilat zhvillojnë vendin. Hoxha fillimisht gjeti gjuhë të perbashkët me Hurshovin por pastaj ndërpreu marrëdhëniet diplomatike me ta. Hoxha që ishte një komunist i përbetuar vazhdoi marrëdhëniet e mira politike dhe diplomatike me Kinën e Mao Ce Dunit pasi që edhe ai njihej si një komunist i fortë.

Vitet e 80-ta sjellin edhe prishjen e marrëdhënieve politico-diplomatike edhe me Kinën e cila si fuqi e atëhershme përkrahi Hoxhën dhe regjimin komunist.Por,pyesim pse Shqipëria po përballlej me izolim total në vet vete,nuk kishte përkrahje nga asnjë shtet tjetër. Cila ishte arsyeja e këtij vetizolimi që ndodhej Shqipëria.A thua vallë mënyra diplomatike e Enver Hoxhës ishte e patakt sa që nga secila marrëdhënie e mirë politike që kishtë me vende të caktuara,qonte Shqipërinë në prishje të atyre marrëdhënieve të mira,pastaj krijonte lidhje të tjera dhe në fund përfundon i vetëm.Enver Hoxha njohej si lider i cili domosdoshmërisht dëshironte dëshirën dhe vullnetin e tij ta bëjë realitet.Qëllimi i tij politik ishte të njihej Ndërkombëtarisht dhe për këtë gjë punonte më së shumti,por se si njihej ai, diplomat i cili ndërton marrëdhënie supportive dhe i mbanë ato për ti shfrytëzuar si resurse në kohën kur i duhet vendit,apo si një lider i cili nuk dëshironte të shoh që bota reformohje përballë ideologjisë komuniste Staliniste.

Diplomatët me qëllim të mirë dhe të pastër politik ndaj vendit të tyre ,punojnë në atë drejtim që ta ngritin vendin në arenën ndërkombëtare ku vendi apo shteti të përfitoj në zhvillimin e tij sikurse politik,ekonomik, të sigurisë dhe përkrahjes nag shtetet që konsiderohen fuqi botërore.Ndërsa Enveri Stalinist,nuk kishte aftësi diplomatike për ta ruajtur dhe zhvilluar Shqipërinë në suaza të mjaftueshme nga e cila do përfitonte jo vetëm shteti,por edhe populli i cili vuajti mjaft shumë gjatë.

Pas vdekjes së Enver Hoxhës erdhi pasardhësi i tij Ramiz Alia e cili e trashëgoi vendin e liderit nga diktatori,falë angazhimit të madh të cilin e kishte bërë për partinë.Ky i fundit

duk e dëmtoi shtetin Shqiptarë më teper por as nuk e ngriti atë për ndonjë përqindje të vogël.

Pas ardhjes së Demokratëve në pushtet dhe deri më tani, Shqipëria ka krijuar marrëdhënie shumë të mira politike dhe diplomatike më fuqitë më të mëdha të këtij shekulli. Përse? Bërja e diplomacisë me shumë takt, adoptimi i praktikave të mira politike të shteteve të forta, komunikimi i hapur dhe respektimi i të drejtave të njerëzve dhe sepse tani i votës së popullit nga Diplomatët e tanishëm, na bënë të shohim Shqipërinë në një sferë krejtësisht ndryshe nga ajo që ishte parë, dhe njohur ndërkombëtarisht. Shqipëria falë lobimit dhe presentimit të denjë diploatesk, arrinë të jetë anëtare e shume Organizatave Ndërkombëtare, arriti të jetë anëtare e NATO-s dhe tani populli Shqiptarë nuk do të njihet si popull emigrant ilegalë siç kishte ndodhur vite më parë, por tani Shqipëtarët kanë të drejtën e lëvizjes së lirë falë liberalizimit të vizave. Shqipëria më këtë mënyrë të qeverisjes dhe më këtë strategji diplomatike do të avansohet dhe zhvillohet edhe më shumë në secilën sferë.

Referenca

1 Avi Primor,Atikulli - What makes a foreign minister great?, *Ha'aretz*, October 20, 2007-
Cituar nga artikulli-Henry Kissinger, Simon & Schuster, 1994, 912 pg.

2 Avi Primor,Atikulli - What makes a foreign minister great?, *Ha'aretz*, October 20, 2007-
Cituar nga artikulli-Henry Kissinger, Simon & Schuster, 1994, 912 pg.

3.Bernd Fischer,Albania and Enver Hoxha's legacy,Open Democracy,June 2010

Bibliografia

Libra

1Geoffrey Roberts, Stalin's Wars, United States, Yale University Press,2008.

2 *Plokhii, S.M. Yalta: The Price of Peace, Viking, February 2010.*

3.Herbert Feis,Betëen War and Peace: Potsdam Conference,Princeton U.P.;Oxford U.P;
1st Edition edition (1960)

4. Kissinger, Henry,*Diplomacy*. New York: Simon & Schuster, 1994.

5. Henry Kissinger, William Burr, *Kissinger Transcripts: The Top Secret Talks With Beijing and Moscow*, 1999

6. Autori: Kastriot Myftaraj Jeta e fshehur e Enver Hoxhës 1908-1944. Vol. 1Plejad 2008

Web faqet

<http://www.spartacus.schoolnet.co.uk/yalta.htm>

<http://www.slideshare.net/rachy25/the-yalta-and-potsdam-conference>

http://www.uv.es/EBRIT/macro/macro_5000_55_29.html

<http://staff.lib.msu.edu/sowards/balkan/lect24.htm>

<http://www.idis.gr/GR/Ekdoseis/newsletters/koppa.pdf>

<http://www.foreignaffairs.com/articles/57556/robert-legvold/the-balkans-from-constantinople-to-communism>

<http://www.panorama.com.al/kulture/montefiore-enver-hoxha-ishte-nje-stalin-i-vogel>

<http://agim.poeticforum.com/t6174-deshmi-kohe-per-njerezit-dhe-historine-tone-tragjike>

<http://www.shqiperia.com/lajme/lajm/nr/3303/Skemat-e-Enver-Hoxhes-per-prishjen-me-Rusine-dhe-Kinen>

http://www.nato.int/issues/nato_albania/practice-alb.html

<http://www.shqiperia.com/kategori/kat/knr/1048/-Levizja-ne-Shengen-pas-liberalizimit-te-vizave>

<http://www.albdiploacademy.com/indexal.html>

<http://www.forumishqiptar.com/showthread.php?t=18576>

<http://www.zeriyt.com/botime-mbi-partite-politike-t33376.0.html>

<http://lajme.shqiperia.com/lajme/artikull/iden/1047017481/titulli/Montefiore-Enver-Hoxha-ishte-nje-Stalin-i-vogel>

http://en.wikipedia.org/wiki/Ramiz_Alia

<http://partisan-news.blogspot.com/2010/06/stalin-politics-and-power.html>

http://www.kohajone.com/html/artikull_12568.html

<http://www.opendemocracy.net/bernd-fischer/albania-and-enver-hoxhas-legacy>